



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 199/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën Iniciativa Qytetare për Drenas (IQD) dega në Drenas, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të ndarjes dhe caktimit të numrit të komisionarëve në Komisionin Komunal Zgjedhor në Drenas për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

### Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datën 08.10.2013, nga Iniciativa Qytetare për Drenas (IQD) dega në Drenas, me të cilën pretendohet se KQZ-ja me vendimin e saj e ka diskriminuar IQD në lidhje me caktimin dhe përfaqësimin e saj vetëm me 22 komisionerë në Këshilla të Vendvotimeve nga 66 sa ka Komuna e Drenasit.

Parashtruesi i ankesës konsideron se vendimi i lartpërmendur është i padrejtë dhe në kundërshtim me çdo normë juridike, prandaj ka kërkuar nga KQZ-ja që ta anuloj vendimin e KKZ-së bazuar në kompetencat e saj .

PZAP-i pasi shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

### ankesa është e palejuar

Meqenëse pretendimet ankimore nga parashtruesi i ankesës janë bërë për shkak se nuk është bërë ndarja dhe caktimi i numërit të njejtë të komisionerve nga radhët e saj në raport me subjektet tjera politike në KVV në Drenas, PZAP-i duke u bazuar në nenin 63.6 të LZP-së, se çdo vendim i KQZ-së nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj dhe neni 122.1 pikat a), b), c), d) e) dhe f) Apelimet Zgjedhore të LZP-së, konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë në kompetencë të PZAP-it për të vendosur se si bëhet shpërndarja e KVV-ve nëpër kuvendet komunale, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, PZAP- i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**

A nr. 199/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Udhëzim Juridik :*** PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i .